V E N D I M
Nr.138, datë 3.4.1991

PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE PRIVATE

Në zbatim të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.7476, datë 12.3.1991 "Për lejimin dhe mbrojtjen e pronës dhe të veprimtarive private", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në bashkëpunim me Komitetin e Riorganizimit të Ekonomisë, të përcaktojnë, brenda muajit prill të vitit 1991, ndërmarrjet, njësitë, sektorët dhe veprimtaritë e veçanta që do të kalojnë nga prona shtetërore në atë private. Me përparësi të fillohet në sektorët e shërbimeve, të artizanatit e të komunales, të tregtisë, të prodhimit të mallrafve të konsumit të gjerë, ushqimore, industriale e artizanale, sidomos në punishtet, repartet, fabrikat, sektorët e ndërmarrjet e vogla që punojnë me cikël të mbyllur, në transportin automobilistik tëë mallrave e të udhëtarëve, në serviset e riparimit, në veprimtaritë shkencore, kulturore e artistike, të shëndetsisë, si dhe në shërbimet dentare, farmaceutike, ambulatore, të avokatisë etj.

2. Veprimtaritë private që krijojnë nga kalimi i pronës shtetërore në pronë private ose që formohen të reja, organizohen e funksionojnë si më poshte;

a) Si individë, që e ushtrojnë veprimtarinë private, duke siguruar vetë mjetet e nevojshme materiale e financiare.

b) Me ortakëri, që krijohet nga bashkimi i kapitaleve të dy ose më shumë individëve. Marrëdhëniet ndërmjet tyre rregullohen në bazë të kontratës që lidhet ndërmjet tyre. Në kontratë shënohet objekti i veprimtarisë, kapitali i derdhur nga secili ortak, pjesa e çdo ortaku në fitim ose në humbje, kohëzgjatja dhe mënyra e likuidimit të ortakërisë, si dhe elemente te tjera.

Ortakët janë solidarë si për të drejtat, ashtu edhe për detyrimet që burojnë nga kontrata e ortakërisë.

c) Me kolektivat ose kooperativat tregtare, prodhuese, të shërbimeve etj., që e ushtrojnë veprimtaritë në përputhje me statutin dhe rregulloren që miratohet prej tyre. Në këto dokumente duhet të përcaktohet objekti i veprimtarisë, masa e pjesmarrjes së kapitalit, mënyra e organizimit dhe e drejtimit, format e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet anëtarëve, rregullat e punësimit e të pagesës të punonjësve jo anëtarë, si dhe rregullat e tjera që kanë të bëjnë me detyrimet ekonomiko-financiare.

d) Ndërmarrje e shoqëri aksionere që krijohen me kapitale monetare e materiale sipas rastit me një ose disa individë, si dhe me aksione. Veprimtaria e tyre zhvillohet në bazë të statutit dhe të rregullores që miratohet prej tyre, në të cilat përcaktohet objekti i veprimtarisë, kapitali bazë, drejtimi administrativ, marrëdhëniet ekonomiko-financiare, ato kontraktore, të punësimit etj.

3. Për blerjen e pasurisë shtetërore nga personat privatë fizikë a juridikë shqiptarë, mund të jepet kredi me interesa të veçantë, sipas kritereve që caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar.

4. Në veprimtaritë private që organizohen si shoqëri aksionere dhe që krijohen nga kalimi i pronës shtetërore në pronë private, vlera nominale e një aksioni nuk mund të jetë më e vogël se 100 lekë.Vlera nominale e një aksioni miratohet nga ministria ose institucioni tjetër qendror përkatës duke marrë parasysh vleftën e objekteve që vihen në shitje, numrin e punonjësve të ndërmarrjes e të njësive shtetërore që punojnë në to, aftësitë blerëse të tyre, si dhe efektivitetin ekonomik e financiar të këtyre objekteve.

Përparësi në realizimin e së drejtës të blerjes së aksioneve t'u jepet punonjësve që punojnë në këto ndërmarrje ose njësi shtetërore.

5. Emetimi i aksioneve bëhet nga ndërmarrja ose shoqëria aksionere. Rregullat për prodhimin, shpërndarjen, ruajtjen, administrimin dhe shitjen e tyre përcaktohen nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar.

6. Nërmarrjet e përbashkëta që krijohen ndërmjet ndërmarrjeve e njësive shtetërore dhe subjekteve private, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të kontratës e të statutit që miratohet prej tyre, ku përcaktohen qëllimi, objekti, kapitali, marrëdhëniet ekonomiko-financiare, ato të punës etj.

7. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore miratojnë krijimin e shoqërive ose të ndërmarrjeve të përbashkëta ndërmjet subjekteve të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të dekretit nr. 7476, datë 12.3.1991 "Për lejimin dhe mbrojtjen e pronës e të veprimtarive private", dhe personave fizikë a juridikë të huaj. Veprimtaria e tyre zhvillohet në përputhje me kontratën dhe me statusin që miratohet prejt tyre.

8. Personat fizikë a juridikë të huaj që kryejnë veprimtari e investime të përbashkëta me persona privatë fizikë e juridikë shqiptarë ose kryejnë veprimtari e investime vetëm me kapitalet e tyre, fillimisht depozitojnë si garanci në Bankën e Shtetit Shqiptar një kapital financiar, masa e të cilit caktohet nga Ministria e Financave sipas rëndësisë ekonomike të degëve e sektorëve të veçantë të ekonomisë.

9. Ministria e Financave, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse, brenda datës 10 Prill 1991, të paraqesë propozimin në Këshillin e Ministrave për kriteret e tarifave të qirasë së tokës dhe të objekteve që do t'u jepen me qira personave privatë fizikë a juridikë vendas e të huaj.

10. Kalimi i ndërmarrjeve dhe njësive shtetërore në pronësi private me kushte lehtësuese bëhet kur mjetet kryesore janë të amortizuara moralisht ose fizikisht në masën mbi 50 për qind dhe kur ndërmarrja ose njësia ka dalë me humbje tre vjetët e fundit radhazi. Shitja e tyre të bëhet me një vleftë jo më pak se 20 për qind të vleftës reale të tyre në momentin e shitjes. Vlerësimi bëhet nga një komision i përbërë nga specialistë të caktuar nga drejtuesi i ndërmarrjes, si dhe me përfaqësues të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe të Bankës së Shtetit Shqiptar në rrethin përkatës. Komisioni miratohet nga seksioni përkatës i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Akti përfundimtar i vlerësimit i dërgohet për miratim ministrisë ose institucionit tjetër qendror që mbulon fushën e veprimtarisë së ndërmarrjes.

Këto ndërmarrje e njësi nuk mund të shiten nga pronarët që i kanë fituar me kushte lehtësuese pa vazhduar veprimtarinë e tyre jo më pak se tre vjet.

11. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore në bashkëpunim me Komitetin e Riorganizimit të Ekonomisë, sipas kushteve konkrete të çdo dege, caktojnë kohën dhe afatin e kalimit të ndërmarrjes e të njësive shtetërore në pronë privatë, si dhe rregullat përkatëse të këtij kalimi.

Autorizimi për shitjen ose dhënien me qira të ndërmarrjeve, njësive shtetërore ose objekteve të veçanta personave fizikë a juridikë të huaj, si dhe për investimet e reja që do të kryhen prej tyre, jepet nga ministritë ose institucionet e tjera qendrore, pasi merret pëlqimi i Komitetit të Riorganizimit të Ekonomisë.

Autorizimi për shitjen ose dhënien me qira të ndërmarrjeve, të njësive shtetërore ose të objekteve të veçanta personave privatë fizikë e juridikë shqiptarë jepet nga ministritë ose institucionet e tjera qendrore përkatëse.

12. Personat privatë fizikë a juridikë shqiptarë mund t'i kalojnë në pronësi ose t'i japin me qira personave fizikë a juridikë të huaj ndërmarrje, njësi ose objekte të veçanta vetëm me autorizimin e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore përkatëse, pasi të merret më parë pëlqimi i Komitetit të Riorganizimit të Ekonomisë.

13. Veprimatritë private ushtrohen në përputhje me dispozitat në fuqi për standardet, çmimet, cilësinë, higjienën, kushtet e punës, sigurimin teknik, mbrojtjen e mjedisit etj, dhe kontrollohen nga organet shtetërore të ngarkuara me detyra në këto fusha.

14. Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë brenda datës 10 prill 1991, të caktojnë rregulla për regjistrimin nga organet financiare e gjyqësore të rretheve të subjekteve të parashikuara në nenet 5, 6 dhe 7 të dekretit nr.7476, datë 12.3.1991 "Për lejimin dhe mbrojtjen e pronës e të veprimtarive private".

15. Në veprimtaritë private marrja në punë e punonjësve bëhet nga vetë punëdhënësit privatë, duke i regjistruar në seksionet e punës të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit ku ushtrohet veprimtaria private.

16. Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave dhe Ministria e Tregtisë së Brendshme, në bashkëpumin me ministritë e institucionet e tjera qendrore, sipas rastit, të përcaktojnë kufijtë maksimalë të çmimeve e të tarifave për disa mallra e shërbime të rëndësishme, ku sigurohet pozita e monopolit që prek nivelin e jetesës së popullit.

17. Ministria e Financave, brenda datës 15 prill të vitit 1991, të caktojë kriteret dhe tarifat për tatimet e taksat që do të zbatohen ndaj personave fizikë e juridike privatë, të cilat të kenë karakter stimulues sipas veprimtarisë dhe në funksion të dobisë shoqërore të tyre.

18. Ministria e Financave, brenda muajit prill të vitit 1991, të përcaktojë taksat doganore për lëndët e para, mallrat e materialet që importohen nga personat privatë fizikë e juridike vendas a të huaj.

19. Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Financave, në bashkëpumin me ministritë e institucionet e tjera qendrore, brenda muajit prill të vitit 1991, të kryejnë studimin dhe të paraqesin në Këshillin e Ministrave propozimet përkatëse për trajtimin me ndihmë sociale të punonjësve që mund të dalin të tepërt nga procesi i privatizimit të sektorit shtetëror.

20. Ministria e Financave, brenda muajit prill të vitit 1991, të përcaktojë rregullat për dokumentimin ekonomiko-financiar, mënyrën e llogaritjes së kontributit, afatet e derdhjes, kontrollin etj., për sigurimet shoqërore të detyrueshme të punonjësve të sektorit privat.

21. Për lëndët e para e materialet, lëndët djegëse dhe materialet e tjera të konsumit që nuk ka çmime të shitjes me pakicë të miratuara, për artikujt që i shiten nga shteti personit fizik a juridik privat, organet përkatëse i caktojnë çmimet sipas këtyre kritereve

- Për artikujt e importit llogaritet një akumulim deri në 50 për qind mbi çmimet e blerjes të konvertuara me kursin ekonomik në fuqi. Kuota konkrete për grup-mallra caktohen nga Ministria e Financave.

- Për lëndët e para dhe materialet e tjera të vendit çmimet e shitjes me pakicë caktohen mbi bazën e çmimeve me shumicë dhe të një akumulimi që zbatohet për artikujt e ngjashëm, për të cilët ka çmime të miratuar atë të shitjes me pakicë.

Norma konkrete e akumulimit për artikujt ose grup-artikujsh që shteti do t'u shesë personave fizikë a juridikë privatë, caktohet nga Ministria e Financave.

22. Vendosja e çmimeve për lëndët e para materialet e mallrat që u shiten personave fizikë a juridikë të huaj, bëhet sipas koniukturës botërore, por ato të jenë jo më të ulëta se çmimet e vendit.

23. Caktimi i çmimeve të shitjes me pakicë të mjeteve kryesore që kalojnë në pronësi private, të bëhet sipas këtyre kritereve:

- Për mjetet kryesore të reja që prodhohen në vend, çmimet e shitjes me pakicë të formohen duke i llogaritur mbi çmimet me shumicë 30 për qind të ardhura neto të centralizuara të shtetit.

- Për mjetet kryesore që importohen nga shteti, çmimet e shitjes me pakicë të caktohen mbi bazën çmimit të blerjes dhe sigurimit të një koeficenti optimal lekë/valutë, kufijtë e të cilit caktohen nga Ministria e Financave.

- Për mjetet kryesore të përdorura, çmimet e shitjes me pakicë formohen si vijon:

Për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit e të tjera të kësaj natyre dhe ndërtesat, vleftës fillestare të pasqyruar në kontabilitet i shtohet jo më pak se 30 për qind tatim mbi xhiro. Ndërtesat që nuk kanë të evidencuar vleftën e plotë fillestare, vlerësimi të bëhet mbi bazën e situacioneve të hartuara sipas manualeve të Ministrisë së Ndërtimit, duke i shtuar kësaj vlefte 30 për qind tatim

mbi xhiro.

Në të gjitha rastet çmimi konkret i shitjes me pakicë caktohet duke zbritur nga vlefta e mësipërme konsumin real të tyre, sipas përcaktimit që do të bëjë komisioni përkatës, pavarsisht nga shkalla e konsumit që pasqyrohet në kontabilitet. Përveç kësaj, në caktimin e çmimit të mbahen parasysh edhe kërkesa e oferta.

Vlerësimi bëhet nga një komision i veçantë me jo më pak se 5 veta. Komisioni miratohet dhe drejtohet nga seksioni përkatës, ku marrin pjesë, përveç specialistëve të tjerë, edhe përfaqësues nga seksioni i financës dhe ai i çmimeve të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Çmimet komunikohen pas miratimit nga byroja e çmimeve në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Këto kritere do të shërbejnë si bazë edhe për rastet kur mjeti kryesor shitet në ankand.

24. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, brenda muajit prill të vitit 1991, të vendosin rregulla organizative të furnizimit materialo-teknik nga shteti të veprimtarive private, me qëllim që të sigurohet vijimësia e procesit të prodhimit e të shërbimit.

25. Për rregullimin e e debi-kredive që mbeten të pambyllura në momentin e kalimit të ndërmarrjes ose të njësisë shtetërore në pronë private, krijohet komisioni i likuidimit, i cili miratohet nga organi që e ka në varësi ndërmarrjen. Afati i veprimtarisë së këtij komisioni nuk mund të jetë më i gjatë se 6 muaj. Pas kësaj periudhe hartohet bilanci kontabël përfundimtar, i cili analizohet, shqyrtohet e miratohet sipas rregullave në fuqi.

26. Personat fizikë e juridikë privatë kanë të drejtë të çelin llogaritë përkatëse pranë bankës dhe i kryejnë veprimet e likujdimit nëpërmjet tyre.

27. Ministria e Financave, brenda datës 15 prill të vitit 1991, të përcaktojë kriteret e llogaritjes së fitimit për personat privatë fizikë e juridikë vendas ose të huaj që ushtrojnë veprimari private.

28. Personat fizikë e juridikë privatë nxjerrin bilance periodike mujore e vjetore dhe i depozitojnë ato në seksionin e financës të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

29. Ministria e Financave, brenda muajit prill të vitit 1991, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit nga personat fizikë e juridikë privatë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin".

30. Të ardhurat që realizohen nga kalimi i pronës shtetërore në atë private, derdhen në buxhetin e shtetit dhe evidencohen e përdoren sipas përcaktimit që bën Ministria e Financave.

31. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.228, datë 11.7.1990, dhe nr.466, datë 31.12.1990, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vndim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
FATOS NANO